

Banka e Shqipërisë



Rezultatet e Vrojtimit të Biznesit dhe të Konsumatorit

Gusht 2009


Publikimi i ardhshëm i rezultateve të vrojtimeve të besimit do të bëhet në 16 nëntor 2009

Tendenca ekonomike

Treguesi i tendencës ekonomike* (TTE) ka regjistruar kthesë të lehtë rritëse në tremujorin e dytë të vitit 2009, pas rënies së theksuar në tremujorin e parë të vitit. Treguesi i tendencës ekonomike u rrit me 10 pikë gjatë tremujorit të dytë, duke shënuar nivelin 81. Megjithatë, ai qëndron afërsisht 19 pikë poshtë mesatares së tij afatgjatë.

Rritja e treguesit të tendencës ekonomike në tremujorin e dytë u ndikua kryesisht nga kontributi pozitiv i treguesit të besimit të konsumatorëve dhe i treguesit të besimit të sektorit të ndërtimit. Sektorët e industrisë dhe të shërbimeve kanë shënuar gjithashtu rritje në tremujorin e dytë të vitit 2009, ndonëse në një shkallë më të ulët. Gjithsesi, niveli i të gjithë treguesve të besimit mbetet i ulët, poshtë mesatareve të tyre historike.

Grafik 1: Treguesi i Tendencës Ekonomike.




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

* Shpjegimet metodologjike mbi mënyrën e ndërtimit të treguesit të tendencës ekonomike, të treguesve të besimit dhe të treguesit të balancës jepen në aneks ose në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë në adresën: http://www.bankofalbania.org/web/pub/metodologjia_vbb_vbk_shqip_2301_1.pdf

Sektori i industrisë

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) është rritur me 1.4 pikë përqindjeje në tremujorin e dytë të vitit 2009. Megjithëse treguesi shënoi rritje në tremujorin aktual, niveli i tij qëndron poshtë mesatares historike me një diferencë prej 15 pikësh përqindjeje. Kthesa drejt rritjes e treguesit të besimit është ndikuar pozitivisht nga vlerësimet më optimiste të bizneseve të industrisë për situatën e prodhimit industrial, për gjendjen e inventarëve të tyre dhe për situatën e punësimit në këtë sektor.

Grafik 2: Treguesi i Besimit të Industrisë.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBI:

Vlerësimi i bizneseve për *ecurinë e ekonomisë* në përgjithësi ka regjistruar rritje në tremujorin e dytë, në ndryshim nga rënia e theksuar në tremujorin e parë. Megjithatë, balanca* e përgjigjeve për këtë pyetje mbetet në nivele negative. Edhe balanca e aktivitetit të përgjithshëm të biznesit në sektorin e industrisë gjatë tremujorit të dytë vijon të jetë negative, pothuaj në të njëjtin nivel si në tremujorin e kaluar. Kjo ecuri është kushtëzuar kryesisht nga situata e ekonomisë botërore, ndikimi i së cilës është vlerësuar negativisht në një shkallë më të lartë krahasuar me faktorët e tjerë.

Pas një rënieje të lehtë në tremujorin e kaluar, *çmimet e prodhimit* industrial janë vlerësuar në rritje në tremujorin aktual.

Pavarësisht vlerësimit më pozitiv që bizneset e industrisë kanë shprehur për *kërkesën e brendshme dhe atë të jashtme* (eksporte), pas rënies së theksuar në tremujorin e kaluar, balancat e tyre janë disa herë më poshtë se mesatarja e shtatë viteve të fundit.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009, 39 për qind e bizneseve të industrisë janë shprehur se *kontratat porositëse* nuk kanë qenë aspak të mjaftueshme (tremujorin e kaluar ky tregues ishte 55 për qind). *Shfrytëzimi i kapaciteteve* prodhuese të bizneseve të industrisë ka njohur rritje me 4 pikë përqindjeje në tremujorin e dytë, duke shënuar vlerën 65.7 për qind.


Pritjet e bizneseve të sektorit të industrisë për *ecurinë e aktivitetit të tyre* si dhe të ekonomisë në përgjithësi, në tremujorin e tretë të vitit janë më optimiste krahasuar me vlerësimin për situatën e tyre korente. Numri i bizneseve që presin rritje të kërkesës është i njëjtë me atë që presin ulje të saj, duke rezultuar në një balancë 0 për kërkesën.

* Shih Aneksin.

Sektori i ndërtimit

Treguesi i besimit të ndërtimit (TBN) është rritur me 4.4 pikë përqindjeje në tremujorin e dytë të vitit 2009 krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Përmirësimi i treguesit të agreguar të sektorit të ndërtimit është shkaktuar nga kombinimi i zhvillimeve me kahe të ndryshme në komponentët përbërës të tij. *Kërkesa* dhe *punësimi* në ndërtim janë vlerësuar më pak negativisht; balanca e tyre u rrit përkatësisht me 11 dhe 4 pikë përqindjeje, duke mbetur gjithsesi në nivele negative. Kritja e këtyre treguesve ka qenë në një masë më të madhe se rënia në balancën e prodhimit (me 2 pikë përqindjeje).

Grafik 3: Treguesi i Besimit të Ndërtimit.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBN:

Vlerësimi i bizneseve të ndërtimit për *ecurinë e ekonomisë* në përgjithësi, megjithëse në përmirësim nga vrojtimi i kaluar, edhe për vrojtimin aktual mbetet në nivele të ulëta negative. Bizneset kanë raportuar se prania e ekonomisë informale është faktori me ndikimin më të madh, i cili ka penguar aktivitetin e tyre. 59 për qind e bizneseve kanë raportuar se *kontratat porositëse* kanë qenë të mjaftueshme ose më shumë se normalja gjatë tremujorit të dytë të vitit, krahasuar me 44 për qind në tremujorin e parë të vitit. Rreth 41 për qind e tyre i vlerëson të pamjaftueshme kontratat e porositura gjatë tremujorit aktual (krahasuar me 57 për qind, në tremujorin e parë).

Shfrytëzimi i kapaciteteve ndërtuese në tremujorin e dytë të vitit 2009 është në masën 67 për qind. Kjo përbën një rritje prej 4.5 pikë përqindjeje nga tremujori i kaluar.


Inventarët janë vlerësuar në rënie edhe gjatë tremujorit të dytë. Në të njëjtën kohë, *gjendja financiare* e bizneseve ka njohur përmirësim në tremujorin aktual. *Çmimet e prodhimit* raportohen të pandryshuara nga tremujori i mëparshëm.

Pritjet për tremujorin e tretë flasin për një përmirësim të mundshëm në sektorin e ndërtimit. Pritjet për çmimet e prodhimit sinjalizojnë një prirje të lehtë rënëse.

Sektori i shërbimeve

Sektori i shërbimeve ka regjistruar një rritje të lehtë të treguesit të besimit në tremujorin e dytë të vitit 2009, pas rënies së theksuar në tremujorin e parë të vitit. Treguesi i besimit për këtë sektor është rritur me 1 pikë përqindje, duke mbetur gjithsesi poshtë mesatares së tij afatgjatë. Megjithëse ecuria e ekonomisë në vend dhe situata e punësimit në sektorin e shërbimeve kanë shënuar rënie, gjendja e tyre financiare ka shënuar përmirësim të ndjeshëm në tremujorin aktual, duke dhënë kontributin kryesor në rritjen e treguesit të agreguar.

Grafik 4: Treguesi i Besimit të Shërbimeve.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBSH:

Bizneset e sektorit të shërbimeve kanë vlerësuar pozitivisht dhe në rritje *aktivitetin* e tyre dhe *kërkesën* për shërbime gjatë tremujorit të dytë të vitit në krahasim me tremujorin paraardhës. *Çmimet* e shërbimeve, pas një prirjeje disa tremujore rënëse, gjatë vrojtimit të rradhës kanë shënuar një kthesë drejt rritjes. Për sa i përket faktorëve që kanë penguar aktivitetin e shërbimeve, bizneset kanë vlerësuar në një shkallë më të lartë marrëdhënien me bankat.


Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në tremujorin e dytë të vitit 2009 është rritur në masën 73.4 për qind, nga 62.2 për qind në tremujorin e mëparshëm. Duke marrë parasysh kërkesën aktuale dhe pritjet për kontratat në 12 muajt e ardhshëm, pjesa më e madhe e bizneseve (rreth 80 për qind e tyre) e vlerësojnë si të mjaftueshëm nivelin aktual të shfrytëzimit të kapacitetit.

Pritjet e firmave të sektorit të shërbimit për tremujorin e ardhshëm sinjalizojnë rritje të aktivitetit në sektorin e shërbimeve në tremujorin e tretë të vitit 2009 dhe përmirësim në situatën e punësimit në këtë sektor.

Besimi i Konsumatorit

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009, treguesi i besimit të konsumatorit (TBK) shënoi një përmirësim të ndjeshëm, duke ndjekur rritjen e lehtë të regjistruar në tremujorin e parë të vitit. TBK u rrit me rreth 8.5 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e mëparshëm, duke kaluar mesataren e tij afatgjatë me 4 pikë përqindjeje. Rritja në treguesin e besimit konsumator u përcaktua nga përmirësimi i të katër balancave përbërëse të tij. Pritjet për situatën e përgjithshme ekonomike dhe situatën e tyre financiare janë pozitive për herë të parë gjatë këtij tremujori. Njëkohësisht, situata e blerjeve dhe e kursimit është përmirësuar, megjithëse balancat e tyre mbeten ende në vlera negative.

Grafik 5: Treguesi i Besimit të Konsumatorit.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Në vijim, analiza e disa treguesve që nuk përfshihen në ndërtimin e TBK:

Situata *ekonomike* dhe *financiare* e konsumatorëve ka njohur përmirësim gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009. Ndërkohë, konsumatorët e perceptojnë si të rritur *koston mesatare të jetesës* gjatë tremujorit të dytë.

Në tremujorin e dytë të vitit, pritjet e kuantifikuara të konsumatorëve për vlerën e *inflacionit pas 12 muajsh* qëndrojnë rreth vlerës 1.7 për qind, 0.3 pikë përqindjeje më pak se në tremujorin e kaluar. Ndërkohë, për herë të parë në tremujorin e dytë 2009, balanca e *pritjeve* të konsumatorëve për çmimet pas një tremujori dhe pas një viti shënoi vlera negative. Për sa i përket nivelit të papunësisë në gjashtëmujorin e ardhshëm, rreth 36 për qind e konsumatorëve presin që ai të rritet dhe rreth 28 për qind e tyre presin që ai të ulet.

Tabelë 1: Treguesit e besimit sipas sektorëve*.

	vlerat që nga T2-2002			2008			2009		Situata	
	min.	mes.	max.	T2	T3	T4	T1	T2	Konjunkturale**	Strukturore***
Industri	-17.9	-1.0	6.2	1.7	0.8	-4.0	-17.9	-16.5	↑	--
Ndërtim	-16.2	-1.5	9.0	7.7	-0.7	1.8	-16.2	-11.8	↑	--
Shërbime	-16.5	1.8	19.4	7.3	19.4	10.1	-5.6	-4.8	↑	-
Konsumator	-20.5	-13.1	-7.8	-11.7	-10.5	-17.4	-17.3	-8.8	↑	--

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Me përjashtim të treguesit të konsumatorit, treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara sezonalisht.

**) Situata krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

***) Situata për secilin tregues konsiderohet shumë e kënaqshme (+ +) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e kënaqshme (+) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; situata konsiderohet e pakënaqshme (-) kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe situata konsiderohet shumë e pakënaqshme (-) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2: Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë*.

	2007	2008				2009		Pritje
	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3
Kërkesa								
Total	7.1	5.9	4.2	7.7	5.4	-11.2	-4.5	7.4
Industri	9.7	3.5	0.1	-1.0	-6.0	-30.1	-26.7	0.0
Ndërtim	11.8	6.5	10.6	0.6	7.2	-22.7	-11.3	7.9
Shërbime	4.1	6.3	2.4	13.7	8.0	0.0	5.4	9.4
Situata ekonomike e firmës								
Total	8.7	8.6	6.9	9.3	6.1	-12.2	-2.6	7.3
Industri	15.5	-2.1	0.0	-5.0	-5.1	-28.9	-29.1	0.2
Ndërtim	7.0	5.8	7.2	-10.7	-1.1	-15.3	-4.0	3.2
Shërbime	7.5	13.2	8.8	23.1	12.8	-5.8	6.1	11.5
Prodhimi								
Total	7.7	11.8	4.5	-2.1	-0.8	-18.8	-19.1	7.7
Industri	8.6	5.3	-0.3	-5.1	-6.2	-27.4	-25.2	8.6
Ndërtim	7.1	15.9	7.5	-0.1	2.6	-13.3	-15.2	7.1
Konsumatorët								
Situata financiare	-9.6	-13.5	-9.7	-3.8	-9.9	-15.0	-4.7	7.9
Kostoja e jetesës	-8.1	-4.6	-6.6	-21.1	-12.4	-20.4	-25.2	-13.0
Çmimet pas 1 viti	27.9	25.2	21.1	23.0	17.3	9.5	-0.3	
Blerje të mëdha	-45.7	-50.9	-45.8	-43.7	-52.7	-50.5	-42.3	-37.6
Kursim	-52.8	-53.2	-50.3	-50.6	-54.4	-52.2	-50.6	-46.2

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Me përjashtim të sektorit të konsumatorëve, balancat janë të rregulluara sezonalisht.

Aneks

Shpjegime metodologjike.

-**Balanca** është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

-**Treguesi i Besimit (TB)** ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht, të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

-**Treguesi i Tendencës Ekonomike (TTE)** përmbledh të gjitha balancat (13) e përdorura për llogaritjen e treguesve të besimit për të katër sektorët, të peshuara sipas aktivitetit ekonomik. Ai shpreh me anë të një treguesi të vetëm ndjesitë për aktivitetin ekonomik në vend të dy prej grupeve kryesore ekonomike; bizneseve dhe konsumatorëve.